Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

CAA
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo
CAA
Nr. i prot. 2026/ZDP/321
Br.prot./Prot.No.
Faqe: 2 Kopje: 1 Datë: 10/11/2026
Stranica/Pages Kopija/Copy Datum/Date
Hyrës/ulazno/in
Dalës/izlazno/out X
Brendshëm/interno/internal
Prishtinë/Priština/Pristina

Nr. Ref: 40/2026
Datë: 10.11.2026

Në mbështetje të nenit 20 paragrafi 1, nenit 23 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-51 për Aviacionin Civil i ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 Për ndryshim dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjenciave të pavaruar, neni 24 paragrafi 1 të Ligjit 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërorë dhe Agjencive të pavarura të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës," nr.7, dt. 1 mars 2019), neni 6 paragrafi 1.4 dhe 2 i Ligjit Nr. 08/l-197 për Zyrtaret Publik. i plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294.

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, nxjerr:

VENDIM

I. Anulohet procedura e rekrutimit me Nr. Ref. RN00020540 për pozitën Drejtor i Pergjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, pa filluar procedura e verifikimit, për shkaqe teknike të paraqitura.

II. Obligohet Udhëheqësja e Njësisë së Burimeve Njerëzore ti marrë të gjitha masat për zbatim të vendimit dhe te bëjë njoftimin e palëve.

III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Pas evidentimit të gabimit teknik në procedurën e rekrutimit me Nr. Ref. RN00020540 për pozitë Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës i publikuar me datë 06.10.2026 në SIMBNJ me afat të aplikimit nga datë 07.10.2026 deri më 05.11.2026, pa filluar procedura e verifikimit AAC anulon në tërësi procedurën e rekrutimit me qëllim që procesi në vijim të mos paraqet pengesa të cilat janë evidentuar në këtë procedurë. Njoftohen përmes e-mailit të gjithë palët në procedurë që kanë aplikuar përmes sistemit SIMBNJ, po ashtu njoftimi publikohet edhe në faqen zyrtare të AAC-së.

Konkursi do të rishpallet në një afat tjetër sipas akteve ligjore në fuqi.

Këshilla Juridike: *Kundër këtij vendimi palët e pakënaqura kanë të drejt ankese ne afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes se këtij vendimi siç parashihet me Ligjin Nr 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative.*
Ankesa dërgohet pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës .

Arianit Islami
U.D Drejtor i Përgjithshëm

Tel: +383 (0)3820074250 | infocaa@caa-ks.org | www.caa-ks.org
Rruga Zejnel Salihu nr.22, | 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Vendimi i dërgohet:

- *Z. Dimal Basha, Ministër i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit;*
- *Njësisë së Burimeve njerëzore;*
- *Kandidatëve në procesin e konkurrimit;*
- *Arkivit të AAC-së;*